



YOUR REFERENCES FOR TAX NEWS IN ALBANIA

December, 2022

AEcO Business Solutions has created the Tax Newsletter, covering the period from January to December 2022 with the aim of providing both local and international businesses with answers to key questions regarding tax regulations in Albania



1.

Tatimpaguesit të cilët përjashtohen nga detyrimi për të lëshuar dhe fiskalizuar fatura

Në datë 10 Janar 2022 u miratua Udhëzimi nr. 27 të datës 31.12.2021 për një ndryshim në udhëzimin e mëparshëm nr. 16 “Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit”, në lidhje me tatimpaguesit, që **përjashtohen nga detyrimi** për të lëshuar fatura të fiskalizuara për furnizimet që kryejnë. Përveç grupeve të mëparshme që përjashtoheshin nga ky detyrim, u vendos që edhe taksistët të pajisur me taksimetër nuk janë të detyruar të lëshojnë fatura të fiskalizuara. Pjesë e këtij përjashtimi janë:

- i. prodhuesit bujqësorë,
- ii. tatimpaguesit që ofrojnë shërbimin taksi të pajisur me taksimetër,
- iii. tatimpaguesit që shesin bileta ose abone për transport pasagjerësh në sektorin e transportit publik urban brenda qytetit,
- iv. shitësit e regjistruar si “ambulantë”.

Po ashtu ndryshimi tjetër në procesin e fiskalizimit ka të bëjë me nenin 20 të Udhëzimit nr.27: “*Regjistrimi i faturave në librin e shitjes dhe librin e blerjes*”, është cituar:

“Me qëllim regjistrimin e faturave të cilat lëshohen në mënyrë të vazhdueshme (ujë, drita, internet, sigurim etj.), të gjithë tatimpaguesit blerës duhet të sigurohen për të përditësuar/saktësuar të dhënat e tyre në kontratën mbi të cilën bazohet furnizimi.”



2.

Zgjatet sërish afati për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme

Në ndryshimet dhe shtesat në ligjin nr. 90/2019, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, të ndryshuar, është bërë e ditur se të gjithë individët që kanë në pronësi pasuri të paluajtshme kanë të drejtë që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit dhe **deri në datën 30 prill 2022** të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut.


Procesi i rivlerësimit të pasurive të paluajtshme nga efektet e këtij ligjit aplikon një tatim 3% nga 15% që është në kushte normale.

Ndërsa afati i pagesave zgjatet më tej deri më 31 korrik 2022.

3.

Banka e Shqipërisë njoftoi fillimin e funksionimit të sistemit AIPS EURO

Në datë 24 Janar 2022, Banka e Shqipërisë njoftoi fillimin e funksionimit të sistemit AIPS EURO për shlyerjen e transfertave vendase në euro, i cili proceson pagesat e klientëve të bankave në euro, brenda vendit. Sistemi AIPS Euro mundëson kryerjen e pagesave në euro brenda vendit me kosto më të ulët dhe afat kohor më të shkurtër nga procesi aktual i kryer nëpërmjet bankave korresponente. Banka e Shqipërisë do të përcaktojë kufijtë mbi komisionet e aplikuar në Euro nga bankat për klientët në mënyrë të ngjashme me politikat e komisioneve të zbatuara për pagesat në Lekë.



4.

Rritja e penaliteteve që lidhen me Ligjin për Regjistrimin e Biznesit

Në datë 15.02.2022 u publikua një ndryshim ligjor në Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

Në nenin 74: Kundravajtjet administrative, u bene ndryshimet e meposhtme.

- Deklarimi në regjistër i të dhënave të pavërteta dënohet me **gjobë 60 000 lekë** (nga 15,000 leke që ishte më parë)
- Moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme brenda afateve të parashikuara përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me **gjobë 60 000** (nga 15,000 leke që ishte më parë)

5.

Ndryshime në SKK 15: “Për Kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikronjësive ekonomike”

Sipas ndryshimit nga Urdhëri nr. 165, datë 13.6.2022, Mikronjësitet me qarkullim më të ulët se 5 milion Lekë duhet gjithashtu të dorëzojnë pasqyrat financiare në format të thjeshtuar.

Standardi do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhën kontabël, që fillon më ose **pas datës 1 janar 2022**. Ndryshimet e miratuara në prill 2022 duhet të zbatohen në mënyrë prospektive nga data 1 janar 2022, pa ndryshuar pasqyrat financiare krahasuese të vitit 2021, të cilat janë përgatitur sipas kërkesave ekzistuese të kontabilitetit.



6.

Nga 7 marsi, aplikimi per rimbursimin e tvsh vetem online

Nga data **7 mars 2022**, çdo kërkesë për rimbursimin e TVSH-së do të bëhet vetëm online, përmes Platformës Dixhitale të Rimbursimit të TVSH-së. Falë automatizimit të sistemit, platforma digjitale e rimbursimit të TVSH-së do të garantojë transparencë të plotë në trajtimin e kërkesave sipas radhës, duke mundësuar në kohë reale përmes numrit të referencës edhe gjurmimin e statusit të aplikimit nga vetë tatimpaguesi, në llogarinë e tij në e-Filing.

7.

Deklarata TVSH-se, librat e blerje/ shitjes do te plotesohen automatikisht nga sistemi i fiskalizimit

Nga data **1 Korrik 2022**, librat e shitjes/blerjes dhe deklarata e TVSH-së do të plotësohen automatikisht, sipas të dhënave të sistemit të fiskalizimit.

Sipas DPT-së, gjatë muajve prill-qershor tatimpaguesve do t'u ofrohet një hapësirë e dedikuar për të raportuar çdo problematikë, që kanë hasur gjatë dorëzimeve manuale në e-filing, me qëllim zgjidhjen e çdo problematike dhe përmirësimin e shërbimit.



8.

Rritja e pages minimale dy here brenda vitit 2022

- **Nga data 01 Prill 2022 deri ne 30 Gusht 2022** - Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, **ishte 32 000 lekë.**
- **Nga data 01 Shtator 2022 e në vijim** - Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, **do të jetë 34 000 lekë.**

Paga bruto mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimit shëndetësor, do të jetë:

1. *Jo më pak se sa paga minimale mujore në shkallë vendi, prej **34.000 lekë** dhe deri në shumën e pagës bruto, sipas deklaratës së listëpagesës, për personat e punësuar;*
2. *Sa dyfishi i pagës minimale në shkallë vendi, prej **68.000 lekë**, për personat e vetëpunësuar dhe punonjësit e papaguar të familjes me të cilët i vetëpunësuar punon e bashkëjeton.*

Si pasojë, **paga maksimale për efekt kontributesh të sigurimeve shoqërore do të jetë 149,954 lekë**

E ardhura nga Paga (lekë/muaj)		E ardhura e tatueshme (lekë/muaj)		Norma tatimore %/muajore
Nga	Deri në	Nga	Deri në	
0	40,000	0	40,000	0%
40,001	50,000	0	30,000	0%
		30,001	50,000	50%*13% të shumës mbi 30,000 lekë
50,001	Më tepër	0	30,000	0%
		30,001	200,000	13% e shumës mbi 30,000 lekë
		200,001	Më tepër	22,100 lekë + 23% të shumës mbi 200,000 lekë

9.

Ndryshimi i Ligjit mbi Të Ardhurat Personale

– me efekt nga 1 Prill 2022

Këshilli i Ministrave me Aktin Normativ Nr. 4, datë 12.3.2022 “Për Një Ndryshim Në Ligjin Nr. 113/2021, “Për Një Ndryshim Në Ligjin Nr. 8438, Datë 28.12.1998, “Për Tatimin Mbi të Ardhurat”, të Ndryshuar” vendosi:

- Tatimpaguesit me të ardhura deri në **40.000 Lekë** nuk do të paguajnë tatim mbi të ardhurat.
- Tatimpaguesit me të ardhura nga **40.001 Lekë** deri në **50.000 Lekë**, do të paguajnë tatim mbi të ardhurat vetëm mbi shumën 30 001 Lekë, që do të llogaritet $50\% * 13\%$ e shumës mbi 30.000 Lekë.
- Tatimpaguesit me të ardhura më tepër se **50.001 Lekë** nuk do të taten për të ardhurat deri **30.000 Lekë**.
- Norma tatimore prej 13% do të llogaritet vetëm mbi fashën 30.001 Lekë – 200.000 Lekë, ndërsa për të ardhurat më shumë se 20.001 Lekë, norma tatimore do të llogaritet 22.100 Lekë + **23%** e shumës mbi **200.000 Lekë**.

Excise



10.

Shtesa dhe ndryshime ne lidhje me zbatimin e Ligjit mbi Akcizat ne Republiken e Shqiperise

Në zbatim të nenit “Humbjet dhe firot” të ligjit Per Akcizat jane shtuar disa pika si me poshte ne lidhje me percaktimin e humbjeve të pakthyeshme dhe normës se firove.

- Pullat fiskale, që shkatërrohen plotësisht gjatë procesit të vendosjes nga makineritë e prodhimit ose ambalazhimit të produkteve të akcizës, konsiderohen si humbje të pranuar, në rast se konfirmohen me deklaratë vjetore të lëshuar nga fabrikat prodhuese ose ambalazhuese, por, në çdo rast, jo më shumë se niveli mesatar vjetor që nuk kalon **0,5% deri 1%*** të totalit të pullave të përdorura nga operatori gjatë vitit.
 - Për këtë sasi pullash, që shkatërrohen plotësisht nga makineritë, nuk përlllogariten detyrime akcize apo penalitete.

*Deri 0.5% për artikujt e kapitullit 24 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave & deri në 1% për rastet e tjera <https://dogana.gov.al/dokument/2842/nomenklatura-2020>

Ndryshime kane ndodhur ne nenin “Per produktet e akcizës pa pullë fiskale, që pranohen në një magazinë fiskale stokimi/magazinë doganore”

- Vendosja e pullave të akcizës në ambientet e magazinave fiskale të stokimit/magazinave doganore kryhet sipas përcaktimeve të nenit qe rregullon menyren e aplikimit te pullave fiskale te Ligjit Per Akcizat.
- Në përfundim të procesit të vendosjes së pullave të akcizës në produktet e akcizës hartohet procesverbali përkatës, në të cilin pasqyrohen të gjitha të dhënat në lidhje me sasinë e pullave të akcizës të vendosura dhe sasinë e produkteve të akcizës sipas llojeve tek të cilat u aplikuan pullat e akcizës.
- Në rastet kur autoritetet doganore mbikëqyrëse sigurojnë prezencën gjatë procesit të vendosjes së pullave, procesverbali nënshkruhet nga përfaqësuesi i autoriteteve doganore dhe depozituesi i miratuar/importuesi.

Deklarata faktike për humbjet e pranuar të pullave, që shkatërrohen plotësisht nga makineritë dhe nuk mund t'i kthehen fizikisht organeve doganore, hartohet nga prodhuesit e mallrave që bëjnë vendosjen e pullave dhe depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave brenda datës 31 mars të çdo viti, për vitin e mëparshëm kalendarik.

Për periudhat e mëparshme përpara hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve, operatorët kanë afat deri më 31 korrik 2022, për dorëzimin e Deklaratave Faktike për Humbjet e Pranuar.



11


Ndryshime ne përcaktimin e rregullave për funksionimin e regjistrit të pronarëve përfitues (RPP) dhe komunikimit elektronik

QKB është institucioni që do të identifikojë subjektet e regjistruara në Regjistrin Tregtar, të cilët janë subjekte raportuese sipas *Ligjit "Për regjistrin e pronarëve përfitues"*, por që nuk kanë përmbushur detyrimin për regjistrimin fillestar të pronarëve të tyre përfitues.

QKB-ja, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI), **brenda datës 30.6.2022**, do të transferojë në Regjistrin e Pronarëve Përfitues (RPP) të dhënat e pronarëve përfitues për subjektet raportuese me pronësi direkte, që kanë qenë të regjistruara në Regjistrin Tregtar përpara datës së krijimit të RPP-se, të cilat në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk kanë përmbushur detyrimin për regjistrimin fillestar të pronarëve të tyre përfitues.

Në rast të mosregjistrimit të të dhënave të pronarit përfitues brenda afatit, subjektit I aplikohen penaltete. Regjistri i Pronarëve Përfitues në kohë reale duhet të njoftojë në mënyrë elektronike, Regjistrin Tregtar dhe Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, për subjektet raportuese të regjistruara pranë tyre, për të cilat është aplikuar gjyba përkatëse.

Me marrjen e njoftimit për sa më lart, e deri në pagimin e saj dhe kryerjen e regjistrimit të detyrueshëm, QKB-ja ose autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse zbaton masat e parashikuara për kundravajtjet administrative sipas Ligjit nr. 112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar.



12.

Nga 1 korriku 2022, të gjithë subjektet janë të detyruar të lëshojnë vetëm fatura të fiskalizuara

Në të kundërt do të aplikohen penaltetet përkatëse të Ligjit për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit.

Afati i fundit, për tatimpaguesit e biznesit të vogël pa TVSH përfundoi me 30 qershor 2022.

- Për të filluar procesin e fiskalizimit, tatimpaguesit duhet të aplikojnë online për t'u pajisur me [certifikatën elektronike të fiskalizimit](#)
- Si dhe duhet të implementojnë një [zgjidhje software](#)-ike për lëshimin e faturave

13.

Kush përjashtohet nga detyrimi për të implementuar një software për lëshimin e faturave të fiskalizuara?

Tatimpaguesit që plotësojnë 4 kushtet e mëposhtme nuk kanë detyrim marrjen e një zgjidhje software për të lëshuar/pranuar fatura, por mund të përdorin platformën Self-Care.

- Nuk janë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar;
- Kanë përgjegjësi tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël;
- Nuk kanë më shumë se një vendndodhje të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- Kanë statusin ligjor "Person Fizik" dhe kategorinë e punësimit "I vetëpunësuar i vetëm".

Cilat janë ndryshimet ligjore të **Paketës Fiskale 2023** në Shqipëri?

Në vijim ndryshimet e miratuara dhe në pritje për miratim në:

- Ligjin për TVSH-ën
- Ligjin për Akcizat
- Ligjin për Procedurat Tatimore
- Ligjin për Taksat Kombëtare
- Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat

Ndryshime në Ligjin 9975/2008, “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar

Në llojet e taksave kombëtare hiqet taksa prej 150 Leke/litër për produktet e mëposhtme:

- Taksa për importimin dhe prodhimin e hirrës së qumështit
- Taksa për importimin dhe prodhimin e krem qumështit

Efektet e këtij ndryshimi shtrihen nga data
1 Janar 2023

Për një ndryshim në ligjin “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar

Ndryshimet e reja në Ligjin mbi Akcizat, heqin përfshirjen në shkallën e taksimit për Pilat, Bateritë Primare dhe Akumulatorët Elektrikë.

Në kategorinë e dytë janë reflektuar ndryshimet në heqjen e kufijve të poshtëm të intervaleve. Kështu, pavarësisht sasisë, birra dhe pijet alkoolike të nënkategorisë S200 taksohen përkatësisht më 710 dhe 84 500 lekë për HL alkool anhidër.

Efektet e këtij ndryshimi shtrihen nga data
1 Janar 2023

Ndryshimet e ndodhura në Ligjin 92/2014 “Për TVSH-ën”

Furnizimi i mallrave/shërbimeve, të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj (nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime) do të trajtohen si furnizime të ngjashme me eksportet.

Nga ana tjetër këto mallra, me cilësinë e mësipërme janë të përjashtuar nga TVSH në import.

Në grupin e furnizimeve të përjashtuara nga TVSH në import është shtuar edhe:

- Importimi i artikujve të përfshirë në kreun 4401 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, me efekt deri në 31 dhjetor 2023 (drutë e zjarrit).

Lista e artikujve të NKM gjenden në linkun në vijim:

<https://www.dogana.gov.al/dokument/3841/nomenklatura-2022>



Shtohet seksioni për:

“Regjimin e veçantë për Bursën Shqiptare të Energjisë”

- Përfshihen nga TVSH importimi dhe furnizimi brenda vendit i energjisë elektrike të destinuar për t'u shitur nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.

Skemë e veçantë e Pagesës së TVSH-së:

- Në rastin e furnizimit të energjisë elektrike të tregtuar nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, TVSH-ja bëhet e kërkueshme në momentin kur shpallen rezultatet në tregjet e ankandeve të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë ose në momentin kur urdhër porositë përputhen në rastin e tregut të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë.
- Deri më 31 dhjetor 2026 TVSH-ja është e pagueshme nga personi i tatueshëm për të cilin kryhet furnizimi me energji elektrike. Për efekt të përlogaritjes së TVSH-së blerësi i energjisë elektrike nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike kryen autongarkesën (reverse-charge) e TVSH-së në cilësinë e personit përgjegjës për pagesën e TVSH-së

Ndryshimet dhe shtesat në Ligjin nr. 9920/2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”

Shtohet detyrimi për të depozituar paratë (cash-in), i cili kalon limitin e lejuar të arkës, në llogarinë bankare

- Shuma maksimale e arkës së tatimpaguesit, që lëshon faturë, varet nga madhësia e qarkullimit vjetor të tatimpaguesit. Bazuar në këtë kriter, tatimpaguesi, mund të caktojë shumën maksimale të parave cash në arkë, si më poshtë viion:

Qarkullimi vjetor (i një viti më parë)	Limiti i lejuar në Arkë
0-2 milion lekë	< 150,000 lekë
2-10 milion lekë	< 500,000 lekë
Mbi 10 milion lekë	< 500,000 lekë* (*ose 5% e qarkullimit vjetor – cilado vlera më e lartë)

Përrjashtim bëjnë tatimpaguesit, që kryen transaksione këmbimi monedhe (exchange), të cilët mund të përcaktojë maksimumin e arkës deri në shumën 5,000,000 lekë ose 5% të qarkullimit vjetor të vitit të kaluar, cilado qoftë vlera më e lartë.

Ndryshime të tjera lidhen me terminologjitë dhe përkufizimet e përdorura në disa terma të ligjit si dhe shtimi i përkufizimeve për terma të rinj apo dhe me ndryshime për të qartësuar më mirë interpretimet e neneve mbi kontrollin tatimor, mënyrën e raportit të kontrollit tatimor, përcaktimi i strukturave dhe funksioneve të hetimit tatimor, etj.

Ndryshime në sanksionet:

Ishte:	U bë
➔ Mosrespektimi i detyrimit për regjistrim apo detyrimit për përditësimin e të dhënave, dënohet me gjobë: 10 000 lekësh për OJF dhe tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin 15 000 lekësh për tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin	10 000 lekësh për personat fizikë dhe 15 000 lekësh për personat juridikë.
➔ Ndryshim i kategorisë së subjektit mbi gjobën për mosmbajtjen e saktë të librave, regjistrave dhe dokumentacionit: - Gjobë 10 000 lekë (për çdo shkelje) për kategorinë biznes i vogël 50 000 lekë për çdo shkelje, në rastet kur është klasifikuar si lloj tjetër biznesi.	- Gjobë 10 000 lekë (për çdo shkelje) për personat fizik apo të vetëpunësuar - Gjobë 50 000 lekë kur është person juridik

Ndryshimet dhe shtesat në Ligjin nr. 9920/2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”- vazhdim

Ndryshime në sanksionet:

Mosdeklarimi në afat i Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave për individ dënohet me **gjobë 3000 Lekë** (nga 5000 Lekë që ishte më parë)

Fshehja dhe mosdeklarimi i pagës reale të punëmarrësit do të dënohet më gjobë sa 200% të detyrimit dhe kontributit të llogaritur **për tatimpaguesit entitete juridike** (dy-fishohet nga 100% që ishte më parë). Ndërsa për tatimpaguesit e tjerë mbetëm masa e gjobës njësoj.

Ndryshime ka dhe në mënyrën e ndarjes së fashave të kategorisë së subjektit, për të cilin aplikohen masat e gjobave të tjera ekzistuese në varësi intervalit që ai i përket, nëse është person fizik, juridik, subjekt i TTHF, TVSH apo TF.

Projektligji “Për Tatimin mbi të Ardhurat”

→ është një ligj i ri, i cili do të zëvendësoj tërësisht ligjin e vjetër.

Ligji i ri vendos rregullat në lidhje me dy shtylla bazë:

1. Tatimin mbi të ardhurat tek personat fizikë dhe entitetet;
2. Tatimin mbi të ardhurat përsa i përket trashëgimisë, donacioneve dhe përfitimit nga lojërat e fatit.

(Ligji i mëparshëm synonte rregullimin sipas tre fushave: tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin dhe tatimit në burim)

Shqyrtimi i këtij ligji pritet të vijojë në vitin 2023, dhe mendohet të nisi efektet e tij nga 1 Janar 2024

Për një pasqyrim të plotë të ligjit të ri, referojuni Newsletter-it tone të radhës.

PAKETA FISKALE 2023

Kontakto:

AECO Business Solutions

+355 68 403 9794

+355 68 904 4437

@aecobusinessolutions



1.

Taxpayers who are exempted from the obligation to issue and fiscalize invoices

On January 10, 2022, was adopted the Instruction no. 27 of 31.12.2021 for a change in the previous instruction no. 16 "On the invoice and the Circulation Monitoring System", regarding taxpayers, who are **exempted from the obligation** to issue fiscalized invoices for the supplies they perform. In addition to the previous groups that were exempted from this obligation, it was decided that even taxi drivers equipped with taximeters are not obliged to issue fiscalized invoices. Part of this exception are:

- i. agricultural producers,
- ii. taxpayers who provide a taxi service equipped with a taximeter,
- iii. taxpayers who sell tickets or subscribe for passenger transport in the urban public transport sector within the city,
- iv. vendors registered as "ambulant".

Likewise, the other change in the fiscalization process is related to Article 20 of Instruction No. 27: "*Registration of invoices in the sales book and the purchase book*", it is quoted:

"In order to register invoices that are issued continuously (water, electricity, internet, insurance, etc.), all purchasing taxpayers must be sure to update/correct their data in the contract on which the supply is based."



2.

The deadline for revaluation of real estate is extended again

In the amendments and additions to the law no. 90/2019, "On the revaluation of real estate", as amended, it is announced that all individuals who own real estate have the right from the date of entry into force of the law and **until April 30, 2022** to reassess this property with the market value.

The real estate revaluation process from the effects of this law applies a 3% tax from the 15% that is under normal conditions.

While the payment deadline is further extended until July 31, 2022.

3.

The Bank of Albania announced the start of operation of the AIPS EURO system

On January 24, 2022, the Bank of Albania announced the start of the operation of the AIPS EURO system for the settlement of domestic transfers in euros, which processes bank customer payments in euros, within the country. The AIPS Euro system enables making payments in euros within the country at a lower cost and shorter time frame than the current process carried out through correspondent banks. The Bank of Albania will determine the limits on commissions applied in Euro by banks to customers in a similar way to the commission policies applied to payments in Lek.



4.

Increased penalties related to the Business Registration Law

On 15.02.2022, a legal amendment was published in Law no. 9723, dated 3.5.2007, "For Business Registration", as amended.

In Article 74: Administrative offences, the following changes were made.

- Declaration of false data in the register is penalized by a **fine of 60,000 lek** (from 15,000 lek that was before)
- Failure to fulfill the obligation for the initial registration and other mandatory registrations within the stipulated deadlines constitutes an administrative offense and is penalized by a **fine of 60,000** (from 15,000 lek that was before)

5.

Changes in NSA 15: "On Accounting and financial reporting of micro-economic entities"

According to the change from Order no. 165, dated 13.6.2022, Microunits with turnover lower than 5 million Lek must also submit financial statements in simplified form.

The standard will be applied to financial statements covering the accounting period beginning **on or after January 1, 2022**. The amendments adopted in April 2022 should be applied prospectively from January 1, 2022, without changing the 2021 comparative financial statements of which are prepared according to existing accounting requirements.



6.

From March 7, the application for the reimbursement of taxes is only online

From **March 7, 2022**, any VAT refund request will only be made online, through the VAT Refund Digital Platform. Thanks to the automation of the system, the digital VAT refund platform will guarantee complete transparency in the processing of requests in order, enabling in real time through the reference number the tracking of the status of the application by the taxpayer himself, in his account in e-Filing.

7.

The VAT declaration, purchase/sale books will be automatically completed by the fiscalization system

From July 1, 2022, the sales/purchase books and the VAT declaration will be completed automatically, according to the data of the fiscalization system.

According to DPT, during the months of April-June, taxpayers will be offered a dedicated space to report any problems they encountered during manual e-filing submissions, with the aim of solving any problems and improving the service.



8.

Increase the minimum wage twice within the year 2022

- **From April 1, 2022 to August 30, 2022** - The minimum monthly basic salary for employees nationwide, which is mandatory to be applied by any legal or natural person, domestic or foreign, **was 32,000 ALL.**
- **From September 1, 2022 onwards** - The minimum monthly basic salary for employees nationwide, which is mandatory to be applied by any person, legal or physical, domestic or foreign, **will be 34,000 ALL.**

The gross monthly salary, for the effect of calculating the mandatory health insurance contributions, will be:

1. *Not less than the national minimum monthly salary, of **ALL 34,000** and up to the amount of the gross salary, according to the payroll statement, for employed persons;*
2. *Twice as the national minimum wage, of **68,000 ALL**, for self-employed persons and unpaid family employees with whom the self-employed person works and lives.*

As a consequence, the maximum salary for the effect of social security contributions will be ALL 149,954

Income from salary (ALL/month)		Taxable income (ALL/month)		Tax Rate %/month
From	To	From	To	
0	40,000	0	40,000	0%
40,001	50,000	0	30,000	0%
		30,001	50,000	50%*13% of the amount over ALL 30,000
50,001	Më tepër	0	30,000	0%
		30,001	200,000	13% of the amount over ALL 30,000
		200,001	Më tepër	ALL 22,100 + 23% of the amount over ALL 200,000

9.

Amendment of the Law on Personal Income – effectively from 1st April 2022

Council of Ministers with Normative Act No. 4, dated 12.3.2022 "On an Amendment to Law No. 113/2021, "On a Change in Law No. 8438, Date 28.12.1998, "On Income Tax", Amended" decided:

- Taxpayers with income up to **ALL 40,000** will not pay income tax.
- Taxpayers with income from **40,001 Lek** to **50,000 Lek** will pay income tax only on the amount of 30,001 Lek, which will be calculated as 50% * 13% of the amount over 30,000 Lek.
- Taxpayers with income exceeding **50,001 Lek** will not be taxed for income up to **30,000 Lek**.
- The tax rate of 13% will be calculated only on the band 30,001 ALL - 200,000 ALL, while for incomes more than 200,001 ALL, the tax rate will be calculated 22,100 ALL + **23%** of the amount over **200,000 ALL**.

Excise



10.

Additions and changes regarding the implementation of the Law on Excise in the Republic of Albania

In implementation of the article "Loss and profits" of the Law on Excise, some points have been added as below regarding the determination of irretrievable losses and the rate of profits.

- Fiscal stamps, which are completely destroyed during the process of placement by the machines of production or packaging of excise products, are considered as accepted losses, in case they are confirmed by an annual statement issued by the manufacturing or packaging factories, but, in any case, not more than the annual average level that does not exceed **0.5% to 1%*** of the total stamps used by the operator during the year.
 - For this amount of stamps, which are completely destroyed by the machines, no excise duties or penalties are calculated.

* Up to 0.5% for items of Chapter 24 of the Combined Nomenclature of Goods & up to 1% for other cases
<https://dogana.gov.al/dokument/2842/nomenklatura-2020>

Changes have occurred in the article "For excise products without a fiscal stamp, which are accepted in a fiscal storage warehouse/customs warehouse"

- The placement of excise stamps in the premises of fiscal storage warehouses/customs warehouses is carried out according to the provisions of the article regulating the manner of application of fiscal stamps of the Excise Law.
- At the end of the process of placing excise stamps on excise products, the relevant minutes are drawn up, which reflect all the data related to the amount of excise stamps placed and the amount of excise products according to the types to which they were applied excise stamps.
- In cases where the supervising customs authorities ensure the presence during the process of affixing the stamps, the record is signed by the representative of the customs authorities and the approved depositor/importer.

The factual declaration for accepted losses of stamps, which are completely destroyed by machines and cannot be physically returned to the customs authorities, is drawn up by the producers of the goods who affix the stamps and is filed with the General Directorate of Customs by March 31 of each year, for the previous calendar year.

For the previous periods before the entry into force of these changes, operators have until July 31, 2022, to submit Factual Declarations for Accepted Losses.



11


Changes in defining the rules for the operation of the register of beneficial owners (RPP) and electronic communication

NBC is the institution that will identify the subjects registered in the Commercial Register, which are reporting subjects according to the Law "On the Register of Beneficial Owners", but which have not fulfilled the obligation for the initial registration of their beneficial owners.

The NBC, in cooperation with the National Agency for the Information Society (AKSHI), **by 30.6.2022**, will transfer to the Register of Beneficial Owners (RPP) the data of the beneficial owners for reporting entities with direct ownership, which have been registered in the Commercial Register before the date of creation of the RPP, which on the date of entry into force of this law have not fulfilled the obligation for the initial registration of their beneficial owners.

In case of failure to register the data of the beneficial owner within the deadline, penalties are applied to the entity. The Register of Beneficial Owners in real time must notify electronically, the Commercial Register and the Register of Non-Profit Organizations, about the reporting entities registered with them, for which the corresponding fine has been applied.

Upon receipt of the notification for the above, until its payment and mandatory registration, the NBC or the authority responsible for maintaining the Register of Non-Profit Organizations applies the measures provided for administrative offenses according to Law no. 112/2020, "On the register of beneficial owners", as amended.



12.

From July 1, 2022, all entities are obliged to issue only fiscalized invoices

Otherwise, the relevant penalties of the Law on Invoice and Circulation Monitoring System will be applied.

The deadline for small business taxpayers without VAT ended on June 30, 2022.

- To start the fiscalization process, taxpayers must apply online to be provided with the [electronic fiscalization certificate](#)
- They should also implement a [software solution](#) for issuing invoices

13.

Who is exempt from the obligation to implement a software for issuing fiscalized invoices?

Taxpayers who meet the following 4 conditions are not required to obtain a software solution to issue/accept invoices, but can use the Self-Care platform.

- They are not subject to value added tax;
- Have tax liability of simplified tax on profit for small business;
- They do not have more than one location of exercising business activity;
- They have the legal status "Physical Person" and the employment category "Sole self-employed".

What are the legal changes of the **Fiscal Package 2023** in Albania?

- Law on VAT
- Law on Excise
- Law on Tax Procedures
- Law on National Taxes
- Law on Income Tax

Amendments to the Law no. 9975/2008, "On National Taxes",

In the types of national taxes, the tax level of 150 Lek/liter is removed for the following products:

- Tax on the import and production of milk whey
- Tax on the import and production of milk cream

The effects of this change extend from 1 January 2023

Amendment to the Law "On EXCISES"

The new changes in the Law on Excise, remove the inclusion in the tax rate for Pilat, Primary Batteries and Electric Accumulators.

The changes in the removal of the lower limits of the intervals are reflected in the second category. Thus, regardless of the quantity, beer and alcoholic beverages of the S200 subcategory are taxed respectively at 710 and 84,500 ALL per HL of anhydrous alcohol.

The effects of this change extend from 1 January 2023

Amendments to the Law no. 92/2014 "On Value Added Tax"

The supply of goods/services, **intended for the realization of projects financed with funds received on the basis of a donation/grant agreement** concluded between the Council of Ministers/Republic of Albania and foreign donors (if the agreement provides that the funds received will not be used to pay taxes) will be treated as exports-like supplies.

On the other hand, these goods, as mentioned above, are exempt from VAT on import.

In the group of supplies exempted from VAT on import has also been **added**:

- **Import of articles included in heading 4401 of the Combined Nomenclature of Goods, with effect until December 31, 2023 (firewood).**

The list of NKM articles can be found in the following link:

<https://www.dogana.gov.al/dokument/3841/nomenklatura-2022>



Added section for:

"The special regime for the Albanian Energy Exchange"

- Import and supply within the country of electricity destined to be sold through the Albanian Electricity Exchange are exempt from value added tax.

Special VAT Payment Scheme:

- In the case of the supply of electricity traded through the Albanian Electricity Exchange, VAT becomes payable at the moment when the results of the day's auctions are announced in advance or within the same day or at the moment when the orders are matched in the case of the continuous market within the same day.
- Until December 31, 2026, VAT is payable by the taxable person for whom electricity is supplied by the Albanian Electricity Exchange. For the purpose of calculating VAT- the buyer of electricity from the Albanian Electricity Exchange carries out the self-charge (reverse-charge) of VAT in the capacity of the person responsible for the payment of VAT.

Amendments to the Law 9920/2008 on Tax Procedures in the Republic of Albania

Is added the obligation to deposit in the bank account, the amount which exceeds the allowed cash limit

- The maximum amount of the taxpayer's cash register, which issues an invoice, depends on the size of the taxpayer's annual turnover. Based on this criterion, the taxpayer can set the maximum amount of cash in the cash register, as follows:

Annual Turnover (previous year)	Allowed limit in Cashier
0-2 milion ALL	< 150,000 ALL
2-10 milion ALL	< 500,000 ALL
Mbi 10 milion ALL	< 500,000 ALL * (*or 5% of annual turnover – whichever is higher)

Exceptions are made for taxpayers who carry out currency exchange transactions, who can determine the maximum amount of cash up to the amount of ALL 5,000,000 or 5% of the annual turnover of the previous year, whichever is the higher value.

Other changes are related to the terminologies and definitions used in some terms of the law, as well as the addition of definitions for new terms or changes to better clarify the interpretations of the articles on tax control, the manner of the tax control report, the definition of structures and tax investigation functions, etc.

Changes on imposed fines:

Was:	Is
→ Failure to comply with the obligation to register or the obligation to update data is penalized by a fine: 10 000 ALL for NGOs and simplified income tax taxpayers 15 000 ALL for Tax on Profit taxpayers	10,000 ALL for natural persons and 15,000 ALL for legal entities.
→ Change regarding the business category whereas the fine is imposed for failure to keep correct books, registers and documentation: - A fine of 10,000 ALL (for each violation) for the small business category 50,000 ALL for each violation, in cases where it is classified as another type of business.	- A fine of 10,000 ALL (for each violation) for natural or self-employed persons - A fine of 50,000 ALL when it is a legal entity

Amendments to the Law 9920/2008 on Tax Procedures in the Republic of Albania - continues

Changes on imposed fines:

Non-declaration of the Annual Individual Income Statement for an individual is punishable by a **fine of 3000 Lek** (from 5000 Lek that was before)

Concealment and non-declaration of the employee's real salary will be punished with a fine of 200% of the liability and contribution calculated **for legal entity taxpayers** (doubled from 100% that was before). While for other taxpayers, the amount of the fine remains the same.

There are also changes in the way of dividing the threshold of the category of the subject, to which the measures of other existing fines are applied depending on the interval to which he belongs, if he is a natural person, legal entity, subject to Simplified Profit Tax, VAT or Profit Tax.

Draftlaw "On Income Tax"

→ **is a new law, which will completely replace the old law**

The new law establishes rules regarding two basic pillars:

1. Income tax for natural persons and entities;
2. Income tax in terms of inheritance, donations and profit from gambling.

(The previous law aimed at regulation in three areas: personal income tax, profit tax and withholding tax)

The review of this law is expected to continue again in 2023, and it is thought to start its effects from January 1, 2024.

For a full coverage of the new law, refer to our next Newsletter.

FISCAL PACKAGE 2023

Kontakto:

AEcO Business Solutions

+355 68 403 9794

+355 68 904 4437

@aecobusinesssolutions



CONTACT

AEcO Business Solution

Ibrahim Kodra str.
Bld. Hawai 2, Entr 1, Ap.18, 3rd floor

+355 68 403 9794

Tirane, Albania

Eriona Dobrovoda

edobrovoda@aeco.al

This material has been prepared for general information purposes only and is not intended to be relied upon as accounting, tax, or other professional advice. Please refer to our advisors for specific advice.